

**VENDIM**  
**Nr.1504, datë 19.11.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË**  
**PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS**  
**LEZHË-SHËNGJIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Lezhë-Shëngjin.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 11 537 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) m<sup>2</sup> tokë/arë, me vlerë 4 937 836 (katër milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, për sipërfaqen 1179 (një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m<sup>2</sup>, tokë, me vlerë 3 751 578 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 8 689 414 (tetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekësh.
  4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 417 000 (katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
  5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 8 689 414 (tetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
  6. Shpronësimi të fillojë më 30 nëntor dhe të përfundojë më 30 dhjetor 2008.
  7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
  8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**